



Planuar / Dituruar Prijemsh/Produktio Received/Delivered	27-01-2023	3	viti god Year
Organ /Njësia Organ /Zjednica Org./Unit	Dr. Prof Prof. No	Shënim + Prilog Appendix	Sasia Kohëzgjatësi Quantity
SKIMSHICK	982/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1160/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas ankesës me numër A.nr.1160/2022 të datës 13.12.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi _____ rë çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1160/2022 e datës 13.12.2022, e parashtruar nga ankuesi _____
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit 195 i datës 13.12.2022, i Komisionit Përzgjedhës në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 13.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit 195 të datës 13.12.2022 të Komisionit Përzgjedhës në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa ky i fundit më datë 10.01.2023 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së kërkesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7963/2022 të datës 13.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Plotësimin e ankesës me numër të protokollit 8262/2022 të datës 21.12.2022; Shkresën e datës 07.12.2022 të parashtruar nga ankuesi te Komisioni Rekrutues në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 695 të datës 08.09.2022 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Vendimin nën shenjën Q.P.Gj.nr.01/2022 të datës 16.03.2022 Mbikëqyrësit të lartë të ankuesit; Vendimin me numër të protokollit 190 të datës 05.12.2022 të Kryesuesit të Komisionit Rekrutues; Kërkesën për përgjime në ankesë të datës 23.12.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 142/2023 të datës 10.01.2023; Kontratën e punës për kohë të pacaktuar të datës 15.07.2020; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 03.01.2020; Vërtetimin me numër të protokollit 1473/2022 të datës 11.11.2022 të Drejtorit të qendrës së paraburgimit më Gjilan; Emalin e datës 12.12.2022 të drejtuar [] Emalin e datës 12.12.2022 të [] drejtuar []; Vendimin me numër të protokollit 195 të datës 13.12.2022; Listën e ngushtë me numër të protokollit 1283 të datës 05.12.2022 të zyrtareve korrektues që kanë plotësuar kushtet formale për pazotën Mbikëqyrës sipas konkursit Rishpallje nr. Protokollit 99 të datës 30.09.2022; Emalin e datës 20.01.2023 me numër të protokollit 616/2022 të [] drejtuar [] lidhur me provat shtesë; Emalin e datës 18.01.2023 të I. Mehmeti Drejtuar [] Shkresat shtese me numër të protokollit 093 të datës 20.01.2023 lidhur me përgjigjen në ankesë; konkursin me numër të protokollit 992 të datës 30.09.2022; Listën e datës 05.12.2022 lidhur me aplikimin e kandidatëve në konkurs; Njoftimin e datës 16.12.2022 të menaxherit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Listën e ngushtë të datës 05.12.2022 të zyrtareve që kanë plotësuar kushtet formale për pozitën Mbikëqyrës i lartë sipas konkursit Rishpallje me NR. Protokollit 992 të datës 30.09.2022; Emalin e datës 09.12.2022 të [] drejtuar [] Njoftimin e datës 20.01.2023 të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit; Emalin e datës 20.01.2023 të [] drejtuar [] Vendimin me numër 13.12.2022; Regjistrin e pranimit të aplikacioneve (pa numër dhe datë); Kërkesën për punësim të datës 01.06.2022 të kandidatit []; Diplomën me Nr. Protokollit 564 të datës 06.06.1991; Vërtetimin me numër të protokollit 1470 të datës 11.11.2022 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan []; Vërtetimin e datës 04.11.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës me të cilën dëshmohet se ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale; Certifikatën nën shenjën PN.NR/7922/2022 të datës 04.11.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 12.12.2020; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 29.01.2022; Kërkesën e datës 01.06.2022 për punësim të kandidatit [] Diplomën me Nr.336/15 të datës 02.04.2015 të lëshuar nga Kolegji AAB; Diplomën me Nr.050/10 të datës 12.03.2010 kolegji AAB; Diplomën me numër 185-P/10 të datës 24.07.2010 të lëshuar nga Universiteti i Sarajevës -Bosnje; Certifikatën nën shenjën PN.Nr.7924/2022 të datës 04.11.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan; Vërtetimin e datës 04.11.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës me të cilën dëshmohet se ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale; Vërtetimin me numër të protokollit 1417/2022 të datës 11.11.2022 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës së paraburgimit në Gjilan; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 10.12.2020; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 12.12.2021; Kërkesën për punësim të datës 01.06.2022 të kandidatit []; Diplomën me numër 0010011 të datës 22.05.2001 lidhure me përfundimin e shkollës së mesme të kandidatit []; Certifikatën nën shenjën PN.Nr.22137/2022 të datës 01.11.2022 të lëshuar nga gjykata Themelore në Gjilan; Vërtetimin e datës 07.11.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës me të cilën dëshmohet se ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale; Vërtetimin me numër të protokollit 1472/22 të

datës 11.11.2022; Vlerësimin e rezultateve në punë (pa datë); Formularin e rezultateve në punë të datës 12.01.2022; Kërkesën për punësim të datës 01.06.2022 të kandidatit _____ Diplomën e datës 08.06.1983; Certifikatën nën shenjën PN.NR.7926/2022 të datës 04.11.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjiilan; Vërtetimin e datës 04.11.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës me të cilën dëshmohet së ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale; Vërtetimin me numër të protokollit 1473/2022 të datës 11.11.2022 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës në Qendrën e Paraburgimit në Gjiilan; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë (pa datë) viti 2020; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 16.01.2022; Kërkesën për punësim të datës 01.06.2022 të kandidatit _____, Diplomën me Nr.873 të datës 08.05.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Vërtetimin e datës 04.10.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës me të cilën dëshmohet së ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale; Certifikatën nën shenjën PN.Nr.5021/2022 të datës 21.10.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Vërtetimin me numër të protokollit 1474/2022 të datës 11.11.2022 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjiilan; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 18.01.2022; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 06.12.2020; Kërkesën për punësim të datës 01.06.2022 të kandidatit Sh. Krasniqi; Diplomën të datës 02.04.2013 lidhur me përfundimin e shkollës së mesme të lartë të kandidati' _____ Vërtetimin me numër të protokollit 1475/2022 të datës 11.11.2022 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjiilan; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 16.01.2022; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 12.12.2020; Vërtetimin e datës 06.07.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës me të cilën dëshmohet së ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale; Certifikatën nën shenjën PN.NR.4102/2022 të datës 27.06.2022 të lëshuar nga gjykata Themelore në Gjiilan; Kërkesën për punësim të datës 01.06.2022 të kandidatit _____; Diplomën (pa datë dhe numër) lidhur me përfundimin e shkollës së mesme të lartë te kandidati _____ Certifikatën nën shenjën PN.NR.7995/2022 të datës 09.11.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore ne Gjiilan; Vërtetimin e datës 09.11.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës me të cilën dëshmohet se ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale; Vërtetimin me numër të protokollit 1476/2022 të datës 11.11.2022; Vlerësimin e rezultateve në pune të datës 10.12.2020; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 12.01.2022; Kërkesën për punësim të datës 01.06.2022 të kandidatit _____; Diplomën me numër të protokollit 1579 të datës 16.06.2000; Certifikatën nën shenjën PN.NR.7763/2022 të datës 01.11.2022; Vërtetimin e datës 01.11.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës me të cilën dëshmohet së ndaj të njëjtit nuk është duke u zhvilluar procedurë penale; Vërtetimin me numër të protokollit 1477/2022 të datës 11.11.2022 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit ne Gjiilan; Vlerësimin e rezultateve ne punë të datës 17.01.2021; Vlerësimin e rezultateve në punë të datës 11.10.2020.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses **është e pabazuar, sepse:**

Referuar nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, më të cilin është përcaktuar se: *1. Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë...*, Kolegji i Këshillit konstatoi se nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë si dhe ligjeve të veçanta lidhur me elementet e marrëdhënies së punës që kanë të bëjnë me: *kushite të veçanta apo shtesë për rekrutim; të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve, rrjedhimisht*

Këshilli ka kompetencë lëndore për trajtimin e kësaj çështje administrative në kuptim të nenit 6 paragrafi 1 dhe nenit 16 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Nga administrimi i provave materiale rezulton së Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 30.09.2022, ka ri-shpallur Konkursin për gradim me numër reference MD/SHKK/019/01.06.2022, për pozitën e punës Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, ku si kritere janë përcaktuar: *Te jetë shtetas i Republikës së Kosovës; Të ketë zotuesi të plotë për të vepruar; Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për gjuhë; Te jete i afte ne pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; Te mos jete i dënuar me vendimin e formës së prere për kryerjen e një vepre me dashje; Të ketë së paku 3 vite përvojë pune në gradën I (zyrtar Korrektues); Të ketë nivelin e arsimit të mesëm; Ne dy vlerësimet e fundit vjetore te jete i vlerësuar me te paktën mire; Te mos ketë mase disiplinore aktive; Dëshminë nga gjykata që nuk është duke zhvilluar procedurën penale ndaj tij.*

Me tej, nga shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi ka aplikuar në konkursin si më lart, por që i njëjti me Vendimin me numër të protokollit 190 të datës 05.12.2022 të Komisionit Përzgjedhës i është refuzuar kërkesa për aplikim, më arsyetimin së nuk plotëson kriteret formale të parapara në konkurs përkatësisht sepse ankuesi ka në fuqi masë disiplinore.

Kundër Vendimit më numër 190 të datës 05.12.2022 ankuesi fillimisht ka parashtruar ankesë të Komisioni Rekrutues në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me numër të protokollit 195 të datës 13.12.2022, ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar duke e lënë në fuqi Vendimin e datës 05.12.2022.

Ankuesi në ankesën e paraqitur në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, pretendon se nuk ka qenë i informuar me herët nga organi i punësimit se ndaj ti është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ju referuar dispozitave të Udhëzimit Administrativ MD-Nr. 02/2022 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, kontrollimi i së kaluarës së tyre, periudha provuese dhe promovim, përkatësisht nenit 3 më të cilin është përcaktuar se: *1. Gradat e zyrtarëve korrektues janë: 1.1. Kadet korrektues; 1.2. Zyrtar Korrektues, Grada-I-; 1.3. Mbikëqyrës, Grada -II-; 1.4. Mbikëqyrës i lartë, Grada-III-; 1.5. Udhëheqës, Grada-IV-“ si dhe nenit 8 po të këtij udhëzimi me të cilin është përcaktuar se:“ Kandidatët që aplikojnë për gradën II përveç kushteve të përgjithshme që parashihen me legjislacionin në fuqi, duhet ti plotësojnë kriteret si në vijim: 1.1. Të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune në gradën I - Zyrtarë Korrektues; 1.2 Shkollimin e mesëm; 1.3. Në dy vlerësimet e fundit vjetore të jetë vlerësuar me të paktën 'mirë'; 1.4. Të mos ketë masë të shqiptuar disiplinore aktive; 1.5 Dëshmi nga Gjykata që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij.*

Andaj, në kuptim të dispozitave ligjore si me lartë, Kolegji i Këshillit ka analizuar aktin e goditur më ankesë dhe si rrjedhojë ka vlerësuar së Komisioni Përzgjedhës me rastin e refuzimit të ankesës së ankuesit të datës 27.11.2022, ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, duke vepruar ne pajtim me ligjin material, ngasë bazuar në provat e lëndës është konstatuar se ankuesi ka në fuqi masën disiplinore “vërejtje” e shqiptuar nga mbikëqyrësi i tij me Vendimin Q.P.GJ.nr.01/2022 të datës 16.03.2022. Ndërlidhur me pretendimin se ankuesi nuk ka qenë në dijeni se ka në fuqi masë disiplinore, Kolegji bazuar në provat e lëndës ka gjetur se ankuesi është ftuar që të pranoj Vendimin P.GJ.nr.01/2022 të datës 16.03.2022, mirëpo i njëjti kishte refuzuar pranimin e tij. Për me tepër, Kolegji




i Këshillit nga shkresat e lëndës vërën faktin së ankuesi me rastin e aplikimit, si pjesë të dokumentacionit të aplikimit kishte bashkangjitur edhe Vërtetimin me numër 1473/2022 të datës 11.11.2022 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, në përmbajte të të cilit është shënuar se: në dosjen e zyrtari korrektues Vllaznim Mustafa ka shkelje të lehtë disiplinore të shqiptuar me datën 16.03.2022. Andaj, bazuar në këto fakte rezulton se janë të pa bazuar pretendimet ankimore të ankuesit së nuk ka qenë në djeni së ka masë disiplinore të shqiptuar.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1160/2022

Avdyl Bekteshi


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-Demi



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

